



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9273 Prot.

Roskovec, më 30, 04 2026

VENDIM

NR 22 .DATË 30 .04 .2026

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËR MUAJIN MARS 2026”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 30.03.2026, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Mars 2026.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2407/1 Prot.

Roskovec, më 30.03.2026

Procesverbal Nr.3

*-I mbajtur sot, datë 30.03.2026, ora 13<sup>00</sup>, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shkurt 2026.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për miratimin e raportit të punës dhe raportit të transparencës në vendimmarrje, të Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2025.
5. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-28 Shkurt 2026.
6. Për një ndryshim në Vendimin Nr.13 datë 26.02.2026 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe Ndërmarrjes vartëse".
7. Për një ndryshim në Vendimin Nr.26 datë 17.04.2024 "Për miratimin e programit të transparencës për Bashkinë Roskovec".
8. Për miratimin e tavaneve përgatitore të PBA 2027-2029.
9. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13<sup>15</sup>

Këshilltarët prezent: A.Plaka, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, Zh.Metushi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, A.Hoxha, A.Pelo.

Këshilltarët që mungojnë: A.Lamaj, E.Çepele, Rr.Hazizi, E.Xhaxhaj, J.Begaj, P.Toro, V.Çepele, S.Bibo Qamili, F.Feleqi, Dh.Malka.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Sekretare e Përgjithshme D.Hoxha, Dr.Financës O.Goga, Sp/Shërbimit Social S.Rrapushi.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 11 këshilltarë. Kryetari – atëherë mirdita. Përshëndetje dhe faleminderit të nderuar këshilltar që u bëtë pjesë e mbledhjes së muajit Mars të Këshillit të Bashkisë Roskovec. Pasi kemi bërë apelin, vërejmë se kuorumi i nevojshëm prej 11 antarësh për zhvillimin e kësaj mbledhje është i

pranishëm. Ashtu sikundër jeni njoftuar në njoftimin e marr nga ju në datën 24.03.2026 për rendin e ditës, në qoftë se ndonjëri nga ju ka diçka për rendin e ditës, apo të kalojmë në votim? Leksi-përderisa këtu skemi ndonjë material shtesë, skemi gjë.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari – atëherë ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë rendin e ditës të mbledhjes së datës 30.03.2026 të Këshillit të Bashkisë Roskovec. Kryetari hedh në votim rendin e ditës dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro. Kryetari- me 11 vota pro miratohet rendi i ditës.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shkurt 2026.

Kryetari- vazhdojmë me një informacion të shkurtër për vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shkurt 2026. Ftoj Sekretaren znj.Arlinda për të bërë një përshkrim të shkurtër të këtij informacioni, të cilin ju e keni pasur në njoftimin që keni marr bashkë me projekt-vendimet e tjera. Leksi- o Kryetar unë kisha diçka, përderisa ne e kemi informacionin këtu, ne e kemi lexuar, besoj se nuk është e nevojshme që Sekretarja të vazhdojë të përsërisi këtë që kemi në material, është mendimi im. Kryetari- kjo është në dëshirën tuaj, gjithsesi informacioni gjithmonë ka qënë më i shkurtri i mundshëm, si të dëshironi.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- procesverbali me të cilin jeni njohur bashkë me projekt-vendimet e tjera, ka dikush ndonjë vërejtje apo diskutim në lidhje me procesverbalin e mbajtur nga Sekretaria? Në qoftë se jo, ju ftoj atëherë të nderuar këshilltar të votojmë procesverbalin e mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak, të mbledhjes së muajit Shkurt. Kryetari hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro. Kryetari- me 11 vota pro miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

4.Për miratimin e raportit të punës dhe raportit të transparencës në vendimmarrje,të Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2025.

Kryetari- kjo është një përmbledhje e asaj çfarë ne kemi bërë, aktivitetet e vitit 2025. Ftoj përsëri Sekretaren znj.Arlinda që shkurtimisht të referojë një përmbledhje të këtij raporti transparence. Sekretarja e Këshillit- përshëndetje të nderuar këshilltar, siç jeni njohur dhe me materialin që keni pasur të shpërndarë, këtu kemi të bëjmë me raportin e punës për vitin 2025 dhe raportin e transparencës në vendimmarrje po për vitin 2025. Informacionin e keni pasur të gjithë, në rast se ju doni shkurtimisht tju sqarojë në lidhje me vendimet që keni marr, sa janë miratuar, sa kanë qënë normative..Kryetari- po Mira..Ermira- jo, i kemi të qarta dhe ta kalojmë në votim. Sekretarja- ok, në rast se keni ndonjë pyetje..Kryetari- atëherë në kushtet që këshilltarët janë njohur me këtë raport dhe propozojnë hedhjen në votim të këtij projekt-vendimi, ju ftoj atëherë të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e raportit të punës dhe raportit të transparencës në vendimmarrje,të Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2025”. Kryetari hedh në votim projekt-

vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro. Kryetari- me 11 vota pro miratohet ky projekt-vendim, ju falenderoj për votimin.

5. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-28 Shkurt 2025.

Kryetari- po urdhëro, fjalën e ka Leksi. Leksi- çdo muaj në mbledhjet e Këshillit ne kemi rënë dakort si të dy grupet e këshilltarëve që jemi këtu, që skemi çka diskutojmë për arsye sepse nuk kemi as të reja, as shtesa, asgjë dhe gjithçka këtu është bazuar në kriteret që kanë përfituar ata të 6%, prandaj unë mendoj si grup ta kalojmë. Kryetari- që ta kalojmë në votim, ok jemi dakort? Atëherë të falenderoj, po duket se këshilltarët e kanë marr informacionin që ju duhet për vlerësimin e këtij projekt-vendimi. Të nderuar këshilltar ju ftoj të votojmë projekt-vendimin “Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-28 Shkurt 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro. Kryetari- me 11 vota pro miratohet dhe ky projekt-vendim.

6.Për një ndryshim në Vendimin Nr.13 datë 26.02.2026 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe Ndërmarrjes vartëse”.

Kryetari- për të relatuar këtë projekt-vendim jo pak të rëndësishëm, është këtu znj.Delina Hoxha Sekretare e Përgjithshme. Sek.e Përgjithshme Delina- përshëndetje të gjithëve të nderuar anëtar të Këshillit. Ju kemi paraqitur për diskutim dhe miratim një ndryshim në vendimin Nr.13 datë 26.02.2026 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe Ndërmarrjes vartëse”. Në fakt në muajin Shkurt ju keni miratuar nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë dhe Ndërmarrjes vartëse, por është bërë vetëm një ndryshim. Është miratuar VKM-ja për punonjësit mësimor dhe është miratuar në datën 27.02.2026 pasi ne kishim paraqitur nivelin e pagave në muajin Shkurt dhe për këtë arsye në këtë projekt-vendim keni të ndryshuar vetëm nivelin e pagave për punonjësit mësimor, pra drejtor dhe edukatore të kopshteve. Gjithashtu edhe të Gjendjes Civile, gjithë pozicionet e tjera janë të pandryshuara. Kryetari- Mira kërkove fjalën? Ermira- ne e dëgjuam dhe në mbledhjen e Kryesisë, nuk e di nëse ka dikush ndonjë gjë për të shtuar, ta kalojmë në votim..Kryetari- faleminderit, kërkon dikush fjalën për diskutim? Pyetje kishim apo është i qartë dhe ky projekt-vendim? Duket se është si pasojë e Vendimit të Këshillit të Ministrave..Ermira- është Vendim i Këshillit të Ministrave dhe do sdo do reflektohen normalisht në rritje page..Kryetari- mirë atëherë duke ju falenderuar, ju ftoj të nderuar këshilltar që të votoni projekt-vendimin “Për një ndryshim në Vendimin Nr.13 datë 26.02.2026 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe Ndërmarrjes vartëse”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro. Kryetari- me 11 vota pro miratohet ky projekt-vendim.

7.Për një ndryshim në Vendimin Nr.26 datë 17.04.2024 “Për miratimin e programit të transparencës për Bashkinë Roskovec”.

Kryetari- besoj dhe këtë projekt-vendim do ta referojë znj.Delina. Delina- unë jam koordinatore për të drejtën e informimit në Bashkinë Roskovec dhe përditësimi i programit të transparencës vjen në zbatim të urdhërit të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, i cili përcakton programin model të transparencës dhe ne e kemi përshtatur atë program në Bashkinë tonë. Theksoj se ndryshimet nuk janë thelbësore, janë vetëm disa ndryshime që synojnë përmirësimin e funksionalitetit të tij, për çdo zë vendoset linku përkatës ku gjendet informacioni. Informacion shtesë që doja tju jepja ishte që Komisioneri për të drejtën e informimit bën monitorimin periodik vjetor të të gjitha institucioneve. Bashkia Roskovec për vitin 2025 rezulton në 12 bashkitë me transparencë proaktive të lartë, me një pikëzim prej 15 nga 16 të mundshme. Faleminderit. Kryetari- faleminderit, fjala është për z.Leksi. Leksi- materialin derisa dhe Sekretarja aty e sqaroi mirë, e kemi parë dhe materialin e kemi lexuar dhe përderisa ne nga Komisioneri jemi vlerësuar do të thotë që kanë qënë gjërat të gjitha transparente, dhe themi që ky projekt-vendim të kalojë, ne si grup do ta votojmë si projekt-vendim. Kryetari- faleminderit, dikush tjetër e kërkon fjalën për pyetje, për diskutime përpara se ta kalojmë në votim këtë projekt-vendim? Atëherë nuk kemi asnjë këshilltar që kërkon fjalën, ju ftoj atëherë të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për një ndryshim në Vendimin Nr.26 datë 17.04.2024 “Për miratimin e programit të transparencës për Bashkinë Roskovec”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 9 vota pro, 2 vota abstenim A.Hoxha, A.Pelo. Kryetari- me 9 vota pro, 2 vota abstenim miratohet ky projekt-vendim. Faleminderit Delina.

#### 8.Për miratimin e tavaneve përgatitore të PBA 2027-2029.

Kryetari- jemi në pritje të Drejtoreshës së Financës znj.Orgesa për të referuar këtë projekt-vendim, fjala është për ju znj.Orgesa. Dr.Financës Orgesa- përshëndeje të nderuar këshilltar, jam para jush për të miratuar projekt-vendimin “Për miratimin e tavaneve përgatitore të PBA 2027-2029”. Në relacion shpjegohet e gjithë baza ligjore, pas shqyrtimit me kujdes të prioriteteve bazuar dhe në planet strategjik të Bashkisë Roskovec, si dhe mundësitë financiare për të përmbushur këto kërkesa, Bashkia Roskovec ka përllogaritur tavanet si më poshtë: ne kemi bërë një parashikim të tre viteve të fundit 2027-2029 po bazuar gjithashtu në buxhetin e vitit 2026. Të ardhurat nga burimet e veta në vitin 2027 parashikohen në mijë lekë 300 mijë, në 2028 300 e 869 mijë dhe 304 në 2029. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme në vitin 2027 parashikohet 229 mijë e 200, në vitin 2028 236 mijë e 500 dhe në vitin 2029 243 mijë e 594. Transferta e pakushtëzuar sektoriale në vitin 2027 parashikohet 109 mijë e 911, në vitin 2028 parashikohet 109 911 dhe në vitin 2029 parashikohet 111 mijë. Të ardhurat nga taksat e ndara në vitin 2027 këto parashikohen 83 mijë e 100, në vitin 2028 parashikohen 83 mijë e 100 dhe gjithashtu në vitin 2029 parashikohen 81 mijë. Leksi- Kryetar më fal një ndërhyrje, përderisa ne e kemi këtë materialin këtu dhe Drejtoresha na e shpjegoi, domethënë normalisht që kjo është bazuar në planifikimet që kemi kaluar në buxhet, besoj se e kemi të qartë, si grup ne votojmë pro këtij projekt-vendimi. Kryetari- pra po më propozoni që mos të vazhdojë referimin por të kalojmë në seancën e pyetjeve dhe diskutimeve? Leksi- unë dhashë mendimin e grupit. Kryetari- po, faleminderit znj.Orgesa. Për pyetje apo për diskutim në lidhje me këtë projekt-vendim e kërkon dikush fjalën? Atëherë kërkesë për pyetje apo diskutim lidhur me këtë projekt-vendim nuk ka, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e tavaneve përgatitore të PBA 2027-2029”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 9 vota pro, 2 vota abstenim

A.Hoxha, A.Pelo. Kryetari- me 9 vota pro, 2 vota abstenim miratohet ky projekt-vendim. Faleminderit dhe punë të mbarë drejtorisë tuaj.

#### 9.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Kryetari- kemi mbërritur të nderuar këshilltar në pikën e fundit të rendit të ditës që është diskutime dhe komente nga qytetarët. Qytetar të pranishëm nuk kemi në këtë mbledhje Këshilli, në qoftë se dikush nga këshilltarët ka diçka për të diskutuar, po fjalën e ka z.Leksi dhe të përgatitet znj.Elizabeta. Leksi- mendoja domethënë sepse mund të na vinte një material për sa thamë në mbledhjen e kaluar dhe një mbledhje më përpara, për punën e zbatimit të afateve të punimeve të firmave që kanë ardhur, domethënë që kanë zbatuar projektet në Bashkinë e Roskovecit. Këtë material nuk e kemi, them ta shtyjmë për në mbledhjen tjetër. Vjet ndoshta kemi kaluar një projekt-vendim që e bëmë vendim, për pjesën që do ti bashkoheshim ASHK-së, domethënë duke ndihmuar me çështjen e legalizimeve, kryesisht tek çështja e legalizimeve dhe shikoj domethënë sepse mua më ngjan si e dështuar kjo pjesë dhe skam parë ndonjë diçka domethënë që nga Bashkia këtu e Roskovecit të marrin legalizimin e shtëpisë, certifikatë toke apo diçka tjetër. Kryetari- pra po kërkon ju një raport në lidhje me zbatimin e atij vendimi që kemi marr ne? Leksi- projekt-vendimit që kaluam vendim. Kryetari- e qartë, faleminderit. Leksi- e treta, është një problem tek pallatet që kanë ndërtuar me kontribut në kohën e mëparshme, e naftëtarëve poshtë, ndoshta ke dhe dijeni Nënkryetar. Atje është çarë soleta dhe atje rrezikohet si rënia e tavanit dhe ça bie jashtë bie brenda, kështu që ata si qytetar atje, si banues që janë në atë pallat kërkojnë zgjidhje nga Bashkia. Kryetari- faleminderit z.Leksi. Maksi- unë do ti kthej të treja përgjigjet Leksit shpejt e shpejt. Përsa i përketë afatit të përfundimit të punimeve, ne jemi në fazën përfundimtare me supervizorët dhe me kolaudatorët, jemi në ditët që po bëjmë konkluzionet përfundimtare dhe në mbledhjen tjetër do të vij raporti i plotë dhe nga supervizorët dhe nga kolaudatorët, gjithashtu dhe nga Bashkia. Ndërsa përsa i përketë pastaj problemit të ASHK-së, dhe ne jemi i po të njëjtit mendim dhe ditën e Mërkurë Drejtoria e ASHK-së do të jetë këtu në Bashkinë e Roskovecit për të konkluduar rreth vendimit të qeverisë për aplikimet për aluiznin..Leksi- me kë do bëj takim, ku do flasi është tjetër gjë, ne duam informacion sa ka gjetur zbatim ky..Maksi- patjetër, pas atij takimi do të japim informacion në mbledhjen tjetër..Leksi- informacioni mund të jetë dhe nga Bashkia se ne i lamë në dispozicion dhe punonjës atyre. Kryetari- po, faleminderit z.Leksi. Maksi- ndërsa për pallatin pastaj do të ngrejme grupin e punës që do filloj që nga nesër në mëngjes për ta parë, në qoftë se është një emergjencë që kërkon zgjidhje, pse se ajo është një pallat pronë private që të jemi korrekt, ndërsa në qoftë se është një emergjencë që kërkon zgjidhje urgjente, do kalojë pastaj për zgjidhje urgjente, të bëj Beni preventivin dhe ti drejtohem Këshillit, se Bashkia nuk mund ti japi zgjidhje çdo lloj pallati që është pronë private e qytetarëve, ndërsa po qe emergjente thashë nga nesër do çojmë grupin e punës. Kryetari- faleminderit, fjalën e kishte kërkuar znj.Elizabeta. Në këtë moment vjen këshilltarja Dh.Malka, ora 13<sup>34</sup>, prezent tani në sallë 12 këshilltar. Dhurata- e di që është drejt fundit, të vij apo? Kryetari- absolutisht je e mirëpritur, e dimë që ke bërë maksimumin tënd dhe të falenderoj. Elizabeta- faleminderit z.Kryetar, kisha një shqetësim në lidhje me një pjesë të komunitetit të lagjes Nr.2, janë nga pjesa e shtatores me kandar deri tek rruga e liqenit të Kurjanit, për pjesën e ndiçimit. Atje nuk funksionon fare ndiçimi për disa muaj, mund të ketë 7 apo 8 muaj diçka e tillë dhe nuk ka ndiçim, dhe është problem sidomos dhe për njerzit që lëvizin tani që u ngroh dhe koha, dalin dhe ndonjë xhiro për nga liqeni, por edhe për moshatarët që

janë aty në lagje. Ka familje që janë vetëm çifte pleqësh domethënë që mund të lëvizin për nevoja, për të shkuar tek spitali apo qoftë edhe që të venë tek koshi për të hedhur mbeturinat, e kanë shumë të vështirë dhe dua që të shikohet me përparësi ky problem, faleminderit. Kryetari- faleminderit Elizabeta, dikush tjetër kërkonte fjalën? Po fjala është për z.Amarildo Hoxha. Amarildo-faleminderit Kryetar. Unë kisha një shqetësim lidhur me një problematikë që ma ka dhënë një qytetar. Ditën e Enjte këtu në Bashki bëhet një takim për qytetarët, priten nga Kryetari i Bashkisë ose nga Nënkyetari. Qytetarët nuk janë persona publik, vijnë për të paraqitur problematikat që kanë por nuk është nevoja që ti publikoni sepse askujt si keni marr leje besoj nga qytetarët, që në facebook-un e Bashkisë, në faqen e Bashkisë ti publikoni atje. Ata vijnë për problemet e tyre, nuk vijnë për të dalë në facebook se fundja fare kanë rjetet e tyre, ata që kanë. Kryetari- pra po thoni që të merret konsenti i qytetarit përpara se të publikohet? Amarildo- patjetër, ku e gjenë të drejtën institucioni publik të më paraqesi mua foton e qytetarit, ai ska dëshirë madje një qytetar siç thashë ma ka thënë, si kam vënë rëndësi ndaj po ta them sot që është edhe Maksi. Ma kishin nxjerrë më bukur foton tha ai, se dhe unë në pashaportë një herë kam dalë tha ai, tha ma kishin nxjerrë aq bukur tha ai, sa i thashë gruas tha ai të ma vëri në vitrinë. Maksi- është e drejta e Bashkisë të pasqyrojë punën e vet që bën..Amarildo- Bashkia pasqyron punën e vet po jo personat, jo qytetarët, ska dëshirë ai..Dhurata- skanë dëshirë të ekspozohen..Maksi- për personat që nuk kanë dëshirë deri më sot nuk kemi pasur ndonjë problematikë..Amarildo- edhe njëherë, unë nuk thashë që mos të pasqyrosh punën e Bashkisë, po të them mos publiko qytetarët që vijnë në takim, sepse nuk keni të drejtë pa i marr leje, se ai vjen për hall nuk vjen për ta publikuar ti në facebook..Maksi- po mirë ata që nuk duan jam plotësisht dakort por megjithatë ne i pyesim qytetarët tani dhe të garantojë..Amarildo- edhe njëherë, unë po ta bie rastin, e di shumë mirë që ti se ke pyetur..Kryetari- Nënkyetar kjo duhet parë në kuadrin e transparencës, si dhe tek ligji i ruajtjes së të dhënave sesi trajtohet dhe besoj se mund të zgjidhet me konsentin..Maksi- po me konsentin e qytetarëve, por di që nuk lejohet ata që janë me aftësi ndryshe..Kryetari- faleminderit dhe për shqetësimin që solle, kishe gjë tjetër? Po urdhëro..Amarildo- meqënëse jemi sërish këtu, e kam ngritur disa herë këtë problematikë, nuk e di janë vënë në dijeni apo jo? Ka ndodhur një incident para 1 jave te shkolla, jeni vënë në dijeni besoj, atje përsëri nuk ka marr zgjidhje, Maksi me ty e kam unë..Maksi- e di se kam qënë me Afrimin atje, jemi konsultuar, kam qënë bashkë me Kryetarin..Amarildo- do i jepni zgjidhje tani si përfundim? Maksi- po, unë di që u dha zgjidhje, në qoftë se nuk është dhënë akoma..Amarildo- nuk është dhënë zgjidhje..Maksi- nga krahu tjetër këtë ishte dhënë zgjidhje, dhe te shkolla do i japim zgjidhje, kemi qënë bashkë me Kryetarin, kemi diskutuar me Drejtorin përkatës të asaj pune për ti bërë..Amarildo- tani ajo ska nevojë për tender besoj, po të jetë nevoja për tender..Maksi- jo, thashë kemi qënë me Kryetarin atë ditë që ka ndodhur..Amarildo- edhe me rërë bituminoze e bëni, se nuk është vend për diskutim më kjo..Kryetari- nuk është çështja tani që të diskutojmë për tendera këtu se unë isha pjesë e atij diskutimi dhe mund të them diçka. Ne në radhë të parë duhet të jemi qytetar sepse problematika që u shkaktua ishte madhore dhe na shpëtoi Zoti si të thuash se ishte fëmijë në mes, po kushdo që të ishte. Çështja është që ne si qytetar duhet të jemi të përgjegjshëm e para dhe mos të shkelim dhe rregullat e qarkullimit, se smund të qarkullosh me atë lloj shpejtësie brenda në fshat, në rrugë të banuar para shkollës, por njëkohësisht shumë njerëz të tjerë që kalojnë aty dhe po ti bësh ato ngritjet shumë të mëdha, dikush që është i kujdesshëm thotë pse duhet ta përjetojë unë këtë gjë, megjithatë në dijenin time dhe të Nënkyetarit Maksit kemi marr një vendim që atje do të vendoset ajo..Amarildo- para shkollave nuk ka asnjë problem që të vendoset, në gjithë botën i ke

pengesat..Kryetari- patjetër, është e drejtë..Amarildo- për pjesë të tjera të rrugës nuk kam kundërshtim..Kryetari- absolutisht nuk e diskutojë fare, është diçka që kemi dakortësinë maksimale dhe..Maksi- e kemi diskutuar dhe me prindin e fëmijës që pati aksident..Kryetari- mirë faleminderit z.Amarildo, po znj.Dhurata..Dhurata- faleminderit Kryetar, unë në fakt do e bëja jo në forëm ankese po kërkesë më shumë, në lidhje me ato kazanët pasi këta të mirëmbajtjes së rrugëve dhe ata që i heqin mbeturinat i marrin por si marrin plotësisht, domethënë gjithandej gjenë mjedis të ndotur rreth kazanëve që si marrin siç duhet, e para. E dyta, janë krijuar disa gropa anës rrugëve se e kam ngritur si problem para disa muajve, disa më duket i mbushët ju të Bashkisë, dikush i mbushi por janë bërë akoma shumë problematike, të paktën tek një urë që është që lidh lagjen Sukun 1 poshtë, te ura që është shtëpia e z.Hajdar Karamani. Atje është një gropë shumë e madhe, që kemi bërë shumë difekte, të gjithë shoferat ankohen për atë, në qoftë se keni mundësi për ta mbushur. Dhe së treti e kisha në forëm pyetje, tani keni vazhduar ndriçimin e zonave, disa qendrave të lagjeve, në lagjen Agaçaj ka mbaruar? Është plotësuar tamam me ndriçim? Se shoh që brenda lagjes sepse është shumë e banuar, se ju e dini që atje është e mbipopulluar, vetëm dy janë vendosur, do vendoset dhe ndonjë tjetër apo? Maksi- që të jemi korrekt, baza ajo që ishte u ndanë sipas njësive administrative dhe mundësive që ne kishim për ndriçimin. Ne kemi ndarë sipas..ne bisedën e kemi bërë me kryetarët e fshatrave së bashku me administratorët dhe gjithçka është mbyllur sot që flasim bashkë. Ato rezerva që kemi nja 12 copë atje, në qoftë se do duhet me çdo kusht që..Dhurata- më fal se po të ndërpres, po ti vësh re përshembull aty në Marinëz gjithë qendra është e plotësuar gjithandej se është zonë e banuar ok, por edhe atje tek ne është zonë e mbipopulluar..Maksi- ishte tjetër investim nuk ishte i Bashkisë, ai investimi i Marinës nuk ishte investimi i Bashkisë që të jemi korrekt, është bërë shumë mirë..Dhurata- se të paktën në çdo kënd të lagjes Agaçaj banesat janë të gjitha të banuara, 2-3 shtëpi janë të braktisura dhe ato vijnë banorët..Maksi- thashë me një konsultim që kemi pasur me kryetarët e fshatrave dhe me administratorët, ne u munduam që ato që kishim, 16 copë përshembull në gjithë Njësinë Administrative Strum, 12 në Kurjan, ca në Roskovec, ca në Kuman, u ndanë. Kemi gjendje një 10-çe që i kemi rezervë, do shikojme dhe kërkesat dhe te Kryetari i fshatit, dhe tuajën për ta parë..Dhurata- nëse keni mundësi të vendosni në ndonjë kënd sepse është lagje me shumë banorë, e mbipopulluar..Maksi- ama u vendosën dy copë atje..Dhurata- dy janë vendosur mesa shoh por..Maksi- jam dakort nëpër kthesa, nëpër vende të ndryshme, nëpër ura e të tjera me radhë kemi menduar ti vendosim..Dhurata- ok, faleminderit. Kryetari- faleminderit znj.Dhurata, dikush tjetër kërkon fjalën? Nuk ka. Kryetari- atëherë meqënëse nuk kemi më kërkesë fjale për diskutime, duke ju falenderuar edhe njëherë të nderuar këshilltar, meqënëse nga sot deri në mbledhjen e radhës kemi në mes dhe nja dy festa, që janë të pashkëve katolike dhe ortodokse, unë uroj për të gjithë ardhshin të mbara ato dhe mirë u takofshim në mbledhjen tjetër. E deklarojë të mbyllur këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak, faleminderit.

**Sekretar**

**Arlinda Hajdini**

**Kryetar**

**Afrim Plaka**